



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
AKADEMIA E SHKENCAVE  
ASAMBLEJA

Prot 636/3

Tiranë, <sup>20</sup>\_\_9.2023

Vendim nr. <sup>53</sup>\_\_\_ datë <sup>20</sup>\_\_9.2023

**Për dhënien e titullit *anëtar nderi* prof. Gerald H. Haug, President i Akademisë Kombëtare të Shkencave të Gjermanisë *Leopoldina***

Mbështetur në nenin 6 pika 3 të Ligjit 53/2019 *Për Akademinë e Shkencave në Republikën e Shqipërisë*;

Referuar nenit 12 pika 1 të Statutit të Akademisë së Shkencave dhe pikës 5 të *Aneksit II* të tij;

Me propozim të Kryesisë dërguar anëtarëve të Asamblesë me shkresën nr. 636 datë 23.8.2023;

Pasi u depozituan sipas kërkesës së saj në shkresën sipërcituar tri referenca rreth personalitetit shkencor të kandidatit të propozuar Gerald H. Haug, President i Asamblesë Kombëtare të Shkencave të Gjermanisë *Leopoldina*, nga anëtarët e Asamblesë akad. Nazim Gruda e akad. Vasil S. Tole e nga znj. Mira Mezini, anëtare e jashtme (bashkëngjitur);

Pasi u mor mendimi i anëtarëve të dy seksioneve të Akademisë së Shkencave, sipas rendit të parashikuar në pikën 3 të nenit 12 të Statutit, dhe u konfirmua vullneti i saj me shprehje mendimi sipas procedurave statutore për vendimet qarkulluese (procesverbali bashkëngjitur);

Asambleja e Akademisë së Shkencave të Shqipërisë

## Vendosi

1. T'i japë titullin *anëtar nderi* të kësaj Akademie prof. Gerald H. Haug, paleoklimatolog, paleo-oqeonograf, paleogjeolog, President i Akademisë Kombëtare të Shkencave të Gjermanisë *Leopoldina*, me këtë

## Motivacion

*Studiues i mirënjohur në shkallë ndërkombëtare për arritjet e tij të shkëlqyera në fushat me rëndësi globale të paleoklimatologjisë, paleo-oqeanografisë dhe paleogjeologjisë detare e nëndetare; vështruar në kushtëzim me progresin e kulturës njerëzore; i vlerësuar me çmime të larta dhe mirënjohje prestigjioze në disa vende të Europës përgjatë më shumë se dy dekadave; anëtar e anëtar nderi në disa akademi motra të "All European Academies" (ALLEA); me një rol personal e institucional shumë të rëndësishëm në mbështetje të konceptimit ligjor dhe të realizimit praktik në proces të reformës në Akademinë e Shkencave të Shqipërisë; i shquar për përkrahjen dashamirëse të progresit të botës shkencore akademike dhe universitare të vendit tonë, duke përfshirë atë në kuadër të nismës së njohur si "Procesi i Berlinit".*

2. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Akad. Skënder GJINUSHI

KRYETAR

